

KEP TRUST

**Raporti i auditorit të pavarur dhe
pasqyrat financiare për vitin që përfundoi
më 31 dhjetor 2025 të përgatitura në
përputhje me Standardet
Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
(SNRF)**

PËRMBAJTJA

FAQE

Raport i auditorit të pavarur	1
Pasqyra e pozicionit financiar	3
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	4
Pasqyra e ndryshimeve në balancën e fondit	5
Pasqyra e rrjedhës së parasë	6
Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare	7 - 60

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e drejtorëve dhe menaxhmentin e KEP Trust

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të KEP Trust ("Organizata" ose "KEP"), që përfshinë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në balancën e fondeve dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e përfunduar në këtë datë, dhe shënimet tjera shpjeguese për pasqyrat financiare duke përfshirë një përmbledhje të politikave materiale të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare shoqëruese paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Organizatës më 31 dhjetor 2025, si dhe performancën e saj financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar në këtë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me *Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë* (Kodit IESBA), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për kontrollet e brendshëm të cilat menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Organizatën apo të ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.

Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare (vazhdim)

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e Organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që Organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë edhe informacione të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksione dhe ngjarje në mënyrë të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Organizatës, në mes tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit, si dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, duke përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që identifikojmë gjatë auditimit.



BDO
BDO Kosova L.L.C.
audit, accounting and financial advisory
Prishtinë, Kosova

Burim Cena,
Partner i angazhimit

BDO Kosova L.L.C.
Rr. Ukshin Hoti, Prime Residence 2, Kati II,
10 000 Prishtinë, Kosovë

8 prill 2026

KEP TRUST**Pasqyra e pozicionit financiar***(Të gjitha vlerat janë të shprehura në '000 Euro përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Shënim	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
PASURITË			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	6	10,110	5,621
Huatë dhe paradhëniet për klientët	7	136,294	112,604
E drejta e përdorimit të pasurive	11	1,306	1,450
Pasuri të tjera	8	220	191
Prona dhe pajisje	9	1,047	1,000
Pasuri të paprekshme	10	566	510
		149,543	121,376
GJITHSEJ PASURITË			
DETYRIMET			
Huamarrjet	12	106,573	84,148
Detyrimi i qirasë	11	1,361	1,489
Provizionet	13	164	284
Detyrimet e tjera	14	604	425
		108,702	86,346
GJITHSEJ DETYRIMET			
BALANCA E FONDIT			
Teprica e akumuluar		40,841	35,030
		40,841	35,030
GJITHSEJ FONDI			
GJITHSEJ DETYRIMET DHE BALANCA E FONDIT			
		149,543	121,376

Këto pasqyra financiare janë miratuar nga ana e bordit të drejtorëve më 8 prill 2026 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


Adrian Alo
Kryeshef Ekzekutiv


Teuta Rexhbeqaj
Kryeshef Financiar

Shënimet nga faqja 7 deri në 60 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST**Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse***(Të gjitha vlerat janë të shprehura në '000 Euro përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Shënim	Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024
Të ardhurat nga interesi	15	21,702	17,933
Shpenzimet e interesit	12	(6,080)	(4,831)
Të ardhurat neto nga interesi		15,622	13,102
Të ardhurat nga tarifat dhe komisionet		114	87
Shpenzimet për tarifat dhe komisionet		(69)	(54)
Të ardhurat neto nga tarifat		45	33
Të hyrat tjera	16	410	399
Shpenzimet e humbjes së kredisë për kreditë dhe paradhëniet për klientët	7	(1,039)	(1,110)
Shpenzimet e personelit	17	(5,598)	(4,846)
Shpenzimet administrative	18	(2,049)	(1,875)
Zhvlerësimi i së drejtës së përdorimit të pasurive	11	(495)	(469)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9,10	(374)	(364)
Humbja nga heqja nga përdorimi i pajisjeve		(1)	(1)
Kostoja e detyrimit të qirasë	11	(101)	(95)
Shpenzimet e provizionit për padi dhe kërkesa	13	17	216
Shpenzimet operative		(9,640)	(8,544)
Teprica para tatimit		6,437	4,990
Shpenzimet e tatimit në fitim	19	(626)	(495)
Teprica neto për vitin		5,811	4,495
Të ardhura tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin		5,811	4,495

Nuk ka asnjë zë në të ardhurat gjithëpërfshirëse në vitin aktual ose atë të mëparshëm përveç fitimit për vitin dhe, në përputhje me rrethanat, nuk paraqitet pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Shënimet nga faqja 7 deri në 60 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST**Pasqyra e ndryshimeve në balancën e fondit***(Të gjitha vlerat janë të shprehura në '000 Euro përveç nëse theksohet ndryshe)*

	Teprica e akumuluar
Balanca më 1 janar 2024	30,535
Gjithsej fitimi gjithëpërfshirës për vitin	
Teprica për vitin	4,495
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-
	<hr/>
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	4,495
	<hr/>
Balanca më 31 dhjetor 2024	35,030
Gjithsej fitimi gjithëpërfshirës për vitin	
Teprica për vitin	5,811
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	-
	<hr/>
Gjithsej të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	5,811
	<hr/>
Balanca më 31 dhjetor 2025	40,841

Shënimet nga faqja 7 deri në 60 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

KEP TRUST

Pasqyra e rrjedhës së parasë

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në '000 Euro përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Teprica para tatimit		6,437	4,990
Rregullimet për:			
Zhvlerësimin dhe amortizimin	9,10	374	364
HPK/Rënie në vlerë e kredive	7	1,039	1,110
Ndryshimi i provizionit për pretendimet ligjore	13	(17)	(216)
Provizion për asete tjera	13	11	-
Paguar për çështje gjyqësore gjatë vitit	13	(114)	-
Humbja nga shlyerja e pajisjeve		1	1
Të ardhurat nga interesi		(21,702)	(17,933)
Shpenzimet e interesit		6,080	4,831
		(7,891)	(6,853)
Ndryshimi në hua dhe paradhënie		(24,513)	(24,650)
Ndryshimi në aktive të tjera		115	(2)
Ndryshimi në detyrime të tjera		(89)	31
		(32,378)	(31,474)
Interesi i arkëtuar		21,486	17,665
Tatimi fitim i paguar		(486)	(554)
Paraja neto e shfrytëzuar nga aktivitetet operative		(11,378)	(14,363)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja e pajisjeve dhe përmirësimet e qirasë	9	(391)	(345)
Blerja e pasurive të paprekshme	10	(87)	(28)
Paratë neto të përdorura në aktivitetet investuese		(478)	(373)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Disbursimet gjatë vitit		56,200	47,929
Shlyerjet gjatë vitit		(33,681)	(31,627)
Interesi i paguar		(6,174)	(4,559)
Para të gatshme neto nga aktivitetet financuese		16,345	11,743
Rritja neto e parasë dhe ekuivalentëve të saj		4,489	(2,993)
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 1 janar		5,621	8,614
Paraja dhe ekuivalentët e saj më 31 dhjetor	6	10,110	5,621

Shënimet nga faqja 7 deri në 60 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare

KEP TRUST

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare

(Të gjitha vlerat janë të shprehura në '000 Euro përveç nëse theksohet ndryshe)

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Veprimtaria

Institucioni Mikrofinanciar - KEP Trust ("Organizata"), e njohur më parë si Kosovo Enterprise Program ("KEP") u themelua nga Organizata Humanitare International Catholic Migration Commission.

Switzerland ("ICMC") dhe Prizren Business Club në gusht 1999, dhe ishte licensuar për të vepruar si një institucion jobankar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ("BQK").

KEP u regjistrua si një Organizatë Jo-Qeveritare ('OJQ') lokale më 4 mars 2002, dhe u regjistrua në BQK si një institucion mikrofinanciar, jo-bankar, siç është përcaktuar në seksionin 2 të Rregullores 1999/21. Aktiviteti primar i KEP është të ofrojë shërbime financiare për individët dhe familjet me të ardhura të ulëta në Kosovë. Me 3 prill 2002, Autoriteti i Bankave dhe Pagesave në Kosovë aprovoi regjistrimin e Organizatës si OJQ vendore.

Më 31 dhjetor 2025, organizata operoi përmes 31 degëve (2024: 31 degë).

Zyra Qendrore e Organizatës gjendet në Rr. Mujë Krasniqi, Nr. 1, Prishtinë, Kosovë.

Organizata udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti Ekzekutiv. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 5 anëtarë dhe të gjithë janë të pavarur dhe nuk janë të lidhur me interesat dhe aktivitetet e Organizatës.

Bordi i Drejtorëve

Më 31 dhjetor 2025, përbërja e Bordit të Drejtorëve të KEP është si më poshtë:

Korab Sejdiu - Kryetar i Bordit

Birgit Rauleder - Anëtare e Bordit

Barbara Wasmus Sajet - Anëtare e Bordit

Elza Herman - Anëtare e Bordit

Arbër Hoti - Anëtar i Bordit

2 BAZA E PËRGATITJES

2.1 Pasqyra e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

2.2 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i organizatës ka bërë një vlerësim të aftësisë së organizatës për vijimësi dhe është i kënaqur që ka burimet për të vazhduar biznesin për një të ardhme të parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është i vetëdijshëm për ndonjë pasiguri materiale që mund të sjellë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar me parimin e vijimësisë. Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten në bazë të parimit të vijimësisë.

2.4 Valuta funksionale dhe prezantuese

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Euro ("EUR"), që është valuta funksionale e organizatës.

2. BAZA E PËRGATITJES (VAZHDIM)**2.5 Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që menaxhmenti të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet e kontabilitetit njihen në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar dhe në çdo periudhë të ardhshme të prekur. Në veçanti, informacioni rreth fushave të rëndësishme të pasigurisë së vlerësimit dhe gjykimeve kritike në zbatimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare, përshkruhen në shënimin 5.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL

Politikat e kontabël të përcaktuara më poshtë janë zbatuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

a) Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. "Norma efektive e interesit" është norma që saktësisht zbret pagesat dhe arkëtimet e vlerësuar të ardhshme të parasë përmes jetëgjatësisë së pritur të instrumenteve financiare (ose, kur është e përshtatshme, një periudhë më e shkurtër) për:

- vlerën kontabël bruto të pasurive financiare, ose
- koston e amortizuar të detyrimeve financiare

Gjatë llogaritjes së normës efektive të interesit për aktivet financiare të rëna në vlerë në blerje ose të krijuara (POCI), një rregullim kreditor i normës efektive të interesit llogaritet duke përdorur flukset e parashikuara të parasë, përfshirë humbjet e pritura të kredisë.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin kostot e transaksionit dhe tarifën dhe pikët e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë kosto shtesë që i atribuohen drejtpërdrejt blerjes ose emetimit të një aktivi financiar ose detyrimit financiar.

Në llogaritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve nga interesi, norma efektive e interesit zbatohet në vlerën kontabël bruto të aktivit (kur aktivi nuk është zhvlerësuar nga kredia) ose në koston e amortizuar të detyrimit.

Sidoqoftë, sipas SNRF 9 për aktivet financiare që kanë rënie në vlerë kreditore pas njohjes fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në koston e amortizuar të aktivit financiar. Nëse aktivi nuk ëka më rënie në vlerë kreditore, atëherë llogaritja e të ardhurave nga interesi kthehet në bazën bruto.

Sipas SNRF 9 për aktivet financiare që kanë qenë të rëna në vlerë kreditore në njohjen fillestare, të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit të rregulluar nga kredia në koston e amortizuar të aktivit. Llogaritja e të ardhurave nga interesi nuk kthehet në bazë bruto, edhe nëse rreziku i rënies në vlerë të asetit përmirësohet.

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet e paraqitura në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (ATGJ) përfshijnë:

- interesi mbi aktivet dhe detyrimet financiare të matura me koston e amortizuar të llogaritur në bazë efektive të interesit;

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**b) Tarifat dhe komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit për një aktiv ose detyrim financiar përfshihen në matjen e normës efektive të interesit.

Sipas SNRF 15, Organizata fiton të ardhura nga tarifat dhe komisionet nga shërbimet financiare që u ofron klientëve të saj. Taksat dhe të ardhurat nga komisioni njihen në një shumë që pasqyron konsideratën në të cilën Organizata pret që të ketë të drejtë në këmbim të ofrimit të shërbimeve.

Detyrimet e performancës, si dhe koha e përmbushjes së tyre, identifikohen dhe përcaktohen, në fillimin e kontratës. Kontratat e të ardhurave të Organizatës zakonisht nuk përfshijnë detyrime të shumëfishta për performancën.

Organizata ofron shërbime për klientët e saj, pagesat faturohen dhe në përgjithësi duhet të paguhen menjëherë pas përmbushjes së një shërbimi të ofruar një kohë të caktuar.

Organizata në përgjithësi ka konkluduar se janë thelbësore kontratat e saj të të ardhurave sepse zakonisht i kontrollojnë shërbimet përpara se t'i transferojë ato tek klienti.

Sipas SNK 18 tarifat e tjera dhe të ardhurat nga komisioni njihen pasi kryhen shërbimet përkatëse. Kur një zotim i kredisë nuk pritet të rezultojë në tërheqjen e një kredie, tarifat e lidhura me angazhimin e kredisë njihen në bazë të drejtpërdrejt gjatë periudhës së zotimit.

c) Shpenzimet e tatimit

Shpenzimet e tatimit përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes të periudhës me përjashtim të rasteve që lidhen me zëra që njihen direkt në ekuitet ose në pasqyrën e të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përfshinë tatimin që pritet të paguhet ose arkëtohet për të ardhurat ose humbjet e tatueshme për periudhën, duke përdorur normat në fuqi në datën e raportimit dhe çdo rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohshme midis vlerave kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe shumave të përdorura për qëllime tatimore. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është një kombinim biznesi dhe që nuk prek as kontabilitetin, as fitimin ose humbjen e tatueshme.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të ndiqnin mënyrën në të cilën Organizata pret në fund të periudhës raportuese, të rimarrë ose shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj.

Tatimi i shtyrë matet me tarifin e tatimeve që pritet të zbatohen për diferencat e përkohshme kur ato kthehen mbrapa, duke përdorur normat e tatimeve të miratuara në mënyrë të konsiderueshme në datën e raportimit.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e zbatueshme me ligj për të kompensuar detyrimet tatimore dhe aktivitetet, dhe ato lidhen me tatimet e vendosura nga i njëjti autoritet tatimor. Taksat shtesë që rrjedhin nga shpërndarja e dividendëve nga Organizata njihen në të njëjtën kohë kur njihet detyrimi për të paguar dividendin e lidhur.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**c) Shpenzimet e tatimit (vazhdim)**

Një aktiv i tatimit i shtyrë njihet për humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore dhe ndryshimet e përkohshme të zbritshme në atë masë sa është e mundshme që fitimet e tatueshme në të ardhmen të jenë të disponueshme, kundër të cilave mund të shfrytëzohen. Aktivet e tatimit të shtyrë rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në atë masë sa nuk ka më mundësi që përfitimi i taksës përkatëse të realizohet.

(iii) Pozicionet e pasigurta tatimore

Pozicionet e pasigurta tatimore të Organizatës rivlerësohen nga menaxhmenti në fund të çdo periudhe raportimi. Detyrimet regjistrohen për pozicionet e tatimit mbi të ardhurat, të cilat përcaktohen nga menaxhmenti si më të mundshme se sa jo të mos rezultojnë në vendosjen e tatimit shtesë nëse pozicionet do të sfidohen nga autoritetet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretimin e ligjeve tatimore që janë miratuar ose janë miratuar në mënyrë thelbësore deri në fund të periudhës së raportimit, dhe çdo gjykatë e njohur ose aktvendime të tjera për çështje të tilla. Detyrimet për gjokat, interesin dhe taksat e ndryshme nga të ardhurat njihen bazuar në vlerësimin më të mirë të menaxhmentit të shpenzimeve të kërkuara për shlyerjen e detyrimeve në fund të periudhës së raportimit.

d) Transaksionet në valutë të huaj

Transaksionet në valutë të huaj shndërrohen në valutën funksionale përkatëse të organizatës me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Pasuritë dhe detyrimet në valutë të huaj në datën e raportimit konvertohen në valutën funksionale me kursin e këmbimit të asaj date

Fitimet dhe humbjet e këmbimit valutor që vijnë si rezultat i shlyerjes së transaksioneve të tilla dhe nga përkthimi në kursin e këmbimit të aktiveve monetare dhe detyrimeve në fund të vitit, njihen në fitim ose humbje.

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të cilat maten me vlerën e drejtë, rivlerësohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur u përcaktua vlera e drejtë.

Zërat jo-monetarë që maten bazuar në koston historike në një valutë të huaj, përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat në monedhë të huaj që vijnë nga konvertimi njihen në fitim ose humbje.

e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare*(i) Njohja*

Organizata njihet një pasuri financiare ose një detyrim financiar në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur organizata bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Pasuritë financiare të organizatës përfshijnë huatë për klientët dhe llogaritë / depozitat me bankat. Detyrimet përfshijnë huazimet nga bankat dhe kreditorët e tjerë, si dhe detyrimet e tjera.

Organizata njihet të gjitha:

- Kreditë për klientët fillimisht me vlerën e drejtë minus tarifat e transaksionit që i atribuohen
- drejtpërdrejt lëshimit të huasë (dmth. tarifa e huasë); dhe
- Huatë nga bankat dhe kreditorët e tjerë me vlerë të drejtë plus kostot e transaksionit të cilat i atribuohen drejtpërsëdrejti huamarrjes (dmth pagesa e borxhit).

Çdo tarifë ose kosto e shkaktuar në depozitat bankare afatshkurtëra dhe të pagueshme tjera pa ndonjë komponentë të konsiderueshme financimi njihen drejtpërdrejt si të ardhura ose shpenzime në llogarinë e fitimit ose humbjes kur krijohen.

KEP nuk përcakton pasuritë ose detyrimet e saj financiare në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në njohjen fillestare.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)***(ii) Klasifikimi***Pasuritë financiare**

Në njohjen fillestare, një pasuri financiare klasifikohet si e matur në: koston e amortizuar, vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDPATGJ) ose vlerës së drejtë përmes fitimit ose humbjes (VDPFH).

Një aktiv financiar matet me koston e amortizuar nëse i plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:

- pasuritë mbahen në kuadër të një modeli biznesi, qëllimi i të cilit është mbajtja e pasurive për mbledhjen e rrjedhave kontraktuale të parasë; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.
- Një instrument borxhi matet në VDPATGJ vetëm nëse plotëson të dyja këto kushte dhe nuk është përcaktuar si në VDPFH:
- pasuritë mbahen brenda një modeli biznesi objektiv i të cilit arrihet si nga mbledhja e rrjedhat
- kontraktuale të parasë dhe shitja e pasurive financiare; dhe
- kushtet kontraktuale të pasurive financiar japin datat e përcaktuara në rrjedhat e parasë të cilat janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit për shumën e principalit të papaguar.

Për njohjen fillestare të një investimi kapital që nuk mbahet për shitje, organizata mund të zgjedhë në mënyrë të pakthyeshme për të paraqitur ndryshimet pasuese në vlerën e drejtë në ATGJ. Kjo zgjedhje bëhen në bazë të investimeve për investime.

Të gjitha pasuritë financiare klasifikohen si të matura me koston e amortizuar.

Vlerësimi i modelit të biznesit

Organizata bën një vlerësim të qëllimit të një modeli biznesi në të cilin një pasuri është mbajtur në një nivel të portfolios, sepse kjo më së miri reflekton mënyrën se si menaxhohet biznesi dhe i jepet informacioni menaxhmentit. Informacioni i konsideruar përfshinë:

- politikat dhe qëllimin e portfolios dhe funksionimin e atyre politikave në praktikë. Në veçanti, nëse strategjia e menaxhimit përqendrohet në fitimin e të ardhurave nga interesi kontraktual, mbajtjen e një profili të veçantë të normës së interesit, përputhjen e kohëzgjatjes së aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve që financojnë ato asete ose realizojnë flukset e parave përmes shitjes së aktiveve;
- si vlerësohet dhe raportohet performanca e portfolios të menaxhmenti i Organizatës;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktiveve financiare të mbajtura brenda këtij modeli biznesi) dhe si menaxhohen ato rreziqe;
- si kompensohen menaxherët e biznesit - p.sh. nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose flukset monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, vëllimi dhe koha e shitjeve në periudhat e mëparshme, arsyet e shitjeve të tilla dhe pritjet e saj për aktivitetin e ardhshëm të shitjes. Sidoqoftë, informacioni mbi aktivitetin e shitjeve nuk konsiderohet i izoluar, por si pjesë e një vlerësimi të përgjithshëm se si arrihet objektiv i deklaruar i Organizatës për administrimin e pasurive financiare dhe si realizohen flukset e parave.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)***(ii) Klasifikimi (vazhdim)****Vlerësimi nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit***

Për qëllimet e këtij vlerësimi, 'principalit' përcaktohet si vlera e drejtë e pasurisë financiare në njohjen fillestare. 'Interesi' përcaktohet si një shpërblim për vlerën kohore të parasë dhe për riskun kreditor që lidhet me shumën e principalit të papaguar gjatë një periudhe të caktuar kohore dhe për risiqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. risku i likuiditetit dhe kostot administrative) si dhe për marzhën e fitimit.

Në vlerësimin nëse rrjedhat kontraktuale të parasë janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit, Organizata konsideron kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshinë vlerësimin nëse pasuritë financiare përmbajnë një term kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e rrjedhat kontraktuale të parasë në mënyrë që ajo të mos plotësojë këtë kusht. Gjatë marrjes së vlerësimit, Organizata konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që do të ndryshonin sasinë dhe kohën e rrjedhave të parasë ;
- karakteristikat e borxhit;
- parapagimi dhe afatet e zgjatjes;
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Organizatës për rrjedhat e parasë nga pasuritë e specifikuar; dhe
- karakteristika që ndryshojnë konsideratën për vlerën kohore të parasë - p.sh. rivendosjen periodike të normave të interesit.

Organizata ka një portfolio të kredive afatgjata me normë fikse për të cilën organizata ka mundësi të propozojë rishikimin e normës së interesit në datat e rivendosjes periodike. Këto të drejta të rivendosjes janë të kufizuara në normën e tregut në kohën e rishikimit. Huamarrësit kanë një mundësi që të pranojnë normën e rishikuar ose të shlyejnë huanë në vlerë nominale pa dënim. Organizata ka përcaktuar që rrjedhat kontraktuale të parasë të këtyre kredive janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit sepse opsioni ndryshon normën e interesit në një mënyrë që është konsideratë për vlerën kohore të parasë, riskun e kredisë, risqet e tjera bazë të huadhënies dhe kostot që lidhen me shumën kryesore të papaguara.

Riklasifikimet

Pasuritë financiare nuk janë riklasifikuar pas njohjes së tyre fillestare, përveç në periudhën pas ndryshimit të modelit të biznesit të saj për menaxhimin e pasurive financiare.

Detyrimet financiare (Politika e aplikueshme para dhe pas 1 janarit 2018)

Organizata klasifikon detyrimet e saj financiare si të matura me koston e amortizuar.

*(iii) Ç'regjistrimi****Pasuritë financiare***

Organizata ç'regjiston një pasuri financiare kur mbarojnë të drejtat kontraktuale për rrjedhjet e parave nga pasuria financiare ose transferon të drejtat për të marrë rrjedhje të parave kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha risiqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë financiare janë transferuar ose në të cilat Organizata as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e pasurisë financiare. Çdo interes në pasuritë financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që është krijuar apo mbajtur nga Organizata njihet si një pasuri ose detyrim në vete.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)***(iii) Ç'regjistrimi (vazhdim)****Pasuritë financiare (vazhdim)***

Në momentin e ç'regjistrimit të një pasurie financiare, diferenca mes vlerës kontabël neto të pasurisë (ose vlera kontabël që i përket pjesës së pasurisë së transferuar), dhe totalit të (i) konsideratës së marrë (përfshirë çdo pasuri të re të përfituar ose detyrim të supozuar) dhe (ii) çdo fitimi ose humbje kumulative që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (vetëm për instrumente borxhi në VDPFH), njihet në fitim ose humbje.

Çdo fitim/humbje kumulative e njohur në ATGJ në lidhje me letrat me vlerë të investimeve të kapitalit të përcaktuara si në VDPATGJ nuk njihet në fitim ose humbje nga ç'regjistrimi i atyre letrave me vlerë. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që kualifikohen për ç'regjistrim që krijohen ose mbahen nga Organizata njihet si një aktiv ose detyrim i veçantë.

Organizata hyn në transaksione me të cilat transferon pasuritë e njohura në pasqyrën e saj të pozicionit financiar, por ruan të gjitha ose në thelb të gjitha risiqet dhe përfitimet e pasurive të transferuara ose një pjese të tyre. Në raste të tilla, pasuritë e transferuara nuk ç'regjistrohen. Shembuj të transaksioneve të tilla janë huatë e letrave me vlerë dhe transaksionet e shitjes dhe riblerjes.

Kur pasuritë i shiten një pale të tretë me një normë totale të kthimit në pasuritë e transferuara, transaksioni trajtohet si një transaksion financimi i siguruar, i ngjashëm me transaksionet e shitjeve dhe të riblerjes, sepse Organizata mban të gjitha ose në thelb të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë së këtyre pasurive.

Në transaksionet në të cilat organizata nuk ruan ose transferon në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë së një pasurie financiare dhe mban kontrollin mbi pasurinë, Organizata vazhdon të njohë pasurinë deri në masën e përfshirjes së saj të vazhdueshme, të përcaktuar sipas masës për të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e pasurisë së transferuar.

Detyrimet financiare

Organizata ç'regjiston një detyrim financiar kur obligimet kontraktuale shlyhen, anulohen ose kanë përfunduar.

(iv) Ndryshimet e pasurive financiare

Nëse kushtet e një pasurie financiare janë modifikuar, Organizata vlerëson nëse flukset e parave të pasurisë të modifikuar janë thelbësisht të ndryshme. Nëse flukset e parave janë në thelb të ndryshme, atëherë të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktiviteti fillestar financiar konsiderohen se kanë skaduar. Në këtë rast, pasuria origjinale financiare ç'regjistrohet dhe një pasuri e re financiare njihet me vlerën e drejtë.

Nëse flukset e parave të aktivitetit të modifikuar të mbartura me kosto të amortizuara nuk janë thelbësisht të ndryshme, atëherë modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim të pasurisë financiare. Në këtë rast, Organizata rillogarit llogaritjen e vlerës totale kontabël të pasurisë financiare dhe njeh shumën që lind nga rregullimi i vlerës kontabël bruto si fitim ose humbje e modifikimit në fitim ose humbje.

(v) Netimi

Pasuritë dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë, dhe vetëm atëherë kur organizata ka të drejtën ligjore për të netuar shumat dhe ajo synon ose të shlyejë ato në një bazë neto ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet sipas SNRF, apo për fitimet dhe humbjet që vijnë nga një grup i transaksioneve të ngjashme sikurse nga aktiviteti tregtar i Organizatës.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(vi) Matja me kosto të amortizuar

'Kosto e amortizuar' e një pasurie ose detyrimi financiar është vlera me të cilën pasuria ose detyrimi financiar matet në njohjen fillestare, minus shlyerjet e principalit, plus ose minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturim, dhe për pasuritë financiare të rregulluara për ndonjë lejim të humbjes së pritshme kreditore. "Vlera kontabël bruto e një pasurie financiare" është kostoja e amortizuar e një pasurie financiare përpara se të rregullohet për çdo zbritje të humbjes së pritshme kreditore.

(vii) Matja e vlerës së drejtë (Politika e aplikueshme para dhe nga 1 janar 2018)

'Vlera e drejtë' është çmimi me të cilin pasuria mund të shitet, ose një detyrim të transferohet, në një transaksion të zakonshëm ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes, në një treg primar ose në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm ku Organizata ka qasje në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron riskun e mospërformancës së tij. Kur është e mundur, Organizata përcakton vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në tregun aktiv për instrumentin. Tregu quhet aktiv kur transaksionet lidhur me pasurinë apo detyrimin ndodhin shumë shpesh dhe me volum të mjaftueshëm për të siguruar informacion të vazhdueshëm për çmimin. Kur nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, Organizata përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e inputeve të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve jo të vëzhgueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshinë gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg do të konsideronin në vendosjen e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar me njohjen fillestare të tij është zakonisht çmimi i transaksionit - për shembull: vlera e drejtë e konsideratës së dhënë ose të marrë. Nëse Organizata vendos se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe se vlera e drejtë nuk është evidentuar as me një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një pasuri apo detyrim identik, e as nuk është e bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet të vrojtueshme në treg, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, i rregulluar për të shtyrë në kohë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo diferencë është njohur në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit por jo më vonë se vlerësimi që mbështetet plotësisht nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut ose kur transaksioni mbyllet.

Nëse një pasuri ose detyrim i matur me vlerën e drejtë ka çmim të ofruar dhe çmim të kërkuar, atëherë Organizata matë pasuritë dhe pozicionet blerëse me çmimin e ofruar dhe detyrimet dhe pozicionet e shitëse me çmim të kërkuar.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në momentin e kërkesës, e cila zbritet nga data e parë kur mund të kërkohej pagesa e depozitës.

Organizata njih transferimet midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë deri në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ky ndryshim në nivelet e vlerës së drejtë.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)
e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Matja e HPK

HPK janë një vlerësim i ponderuar i probabilitetit të humbjeve kreditore dhe do të maten si më poshtë:

- pasuritë financiare që nuk janë të rëna në vlerë në datën e raportimit: vlera aktuale e të gjitha
- humbjeve në mjete monetare - d.m.th. diferenca midis rrjedhave të parasë që i detyrohen njësisë ekonomike në përputhje me kontratën dhe rrjedhat e parasë që Organizata pret të marrë;
- pasuritë financiare që janë të rëna në vlerë në datën e raportimit: diferenca midis vlerës kontabël bruto dhe vlerës aktuale të rrjedhave të parasë të ardhshme të vlerësuara;
- vlera aktuale e diferencës ndërmjet rrjedhave kontraktuale të parasë që i detyrohen Organizatës nëse tërheqja e zotimit dhe rrjedhat e parasë që Organizata pret të marrë;

Përkufizimi i vonesave

Sipas SNRF 9, Organizata do të konsiderojë një pasuri financiare në vonesë kur:

- huamarrësi nuk ka gjasa të paguajë detyrimet e tij të kredisë në Organizatë në tërësi, pa pasur nevojë nga ana e Organizatës për veprime të tilla si realizimi i sigurisë (nëse ka ndonjë të tillë); ose
- huamarrësi ka më shumë se 90 ditë të kaluara për çdo detyrim material kredie në Organizatë.

Ky përkufizim është kryesisht në përputhje me përkufizimin e përdorur për qëllime rregullatore për kreditë e klasifikuara si të dyshimta ose të humbura.

Në vlerësimin nëse një huamarrës është në vonesë, Organizata do të konsiderojë që treguesit janë në përputhje me kërkesat rregullatore të riskut për klasifikimin e kredive si të dyshimta ose të humbura:

- cilësore: p.sh. shkeljet e kovenantave kontraktuale;
- sasiorë: p.sh. statusi i vonuar dhe mos pagesa e një detyrimi tjetër të të njëjtit huamarrës në Organizatë; dhe
- klasifikimi rregullator i riskut të huamarrësve të njëjtë në banka të tjera. Inputet në vlerësimin nëse një instrument financiar është në vonesë dhe rëndësia e tyre mund të ndryshojë me kalimin e kohës për të reflektuar ndryshimet.

Nivelet e riskut kreditor

Organizata vendos çdo ekspozim në një klasë të riskut kreditor bazuar në kërkesat e përcaktuara nga rregullorja e Menaxhimit të Riskut të Kredisë duke përdorur faktorë cilësorë dhe sasiorë që tregojnë riskun e vonesave. Krahas klasave të riskut të prezantuara për qëllime rregullatore, Organizata identifikon dhe monitoron veçmas kreditë standarde në vonesë nga kreditë standarde jo në vonesë.

Çdo ekspozim do të alokohet në një klasë të riskut kreditor për njohjen fillestare bazuar në informacionin në dispozicion për huamarrësin. Ekspozimet do t'i nënshtrohen monitorimit të vazhdueshëm, gjë që mund të rezultojë në një ekspozim të zhvendosur në një klasë të riskut kreditor.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Rritja e ndjeshme e riskut kreditor

Rritja e ndjeshme e riskut të vonesave dhe vonesat vetë janë përcaktuesit kryesorë për llogaritjen e humbjeve të pritshme kreditore.

Në çdo datë raportimi, Organizata vlerëson nëse ka pasur një rritje të ndjeshme në riskun kreditor duke krahasuar: (i) riskun që kredia do të jetë në vonesë në datën e raportimit ose pas datës së raportimit dhe (ii) riskun e vonesave të vlerësuara në ose pas datës së njohjes së saj fillestare.

Gjatë kryerjes së këtij vlerësimi, Organizata konsideron informata të arsyeshme dhe të mbështetshme dhe informata historike për kreditë individuale ose grupe kredish kur informacioni i arsyeshëm dhe i mbështetur nuk është i disponueshëm në baza individuale. Matja e modelit HPK pasqyron modelin e përgjithshëm të përkeqësimit ose përmirësimit të cilësisë kreditore të instrumenteve financiare, shprehur në aspektin e rritjes së ndjeshme të riskut kreditor. Kur instrumenti financiar fillimisht gjenerohet, lejimi i humbjeve matet në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore 12-mujore. Kur risku i vonesave të instrumentit është rritur ndjeshëm që nga krijimi i tij, Organizata do të masë lejimin e humbjeve në një shumë të barabartë me humbjet e pritshme kreditore të përhershme.

Organizata do të monitorojë efektivitetin e kriterëve të përdorura për të identifikuar rritje të ndjeshme në riskun kreditor, nëpërmjet rishikimeve të rregullta për të konfirmuar se:

- kriteret janë në gjendje të identifikojnë rritje të ndjeshme në riskun kreditor para se një ekspozim tëjetë në vonesë;
- koha mesatare në mes të identifikimit të një rritjeje të konsiderueshme të riskut kreditor dhe vonesës të duket e arsyeshme; dhe
- ekspozimet në përgjithësi nuk transferohen drejtpërdrejt nga matja HPK 12-mujore ndaj rënies në vlerë të kredisë.

Përcaktimi nëse risku kreditor është rritur ndjeshëm

Sipas SNRF 9, kur përcaktohet nëse risku kreditor (d.m.th. risku i vonesës) për një instrument financiar është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare, Organizata do të konsiderojë informata të arsyeshme dhe të mbështetshme që janë relevante dhe të disponueshme pa kosto ose përpjekje të panevojshme, informata cilësore dhe analiza bazuar në përvojën historike të Organizatës, vlerësimin e kreditor të ekspertëve dhe informacionin e ardhshëm. Organizata do të identifikojë kryesisht nëse ka ndodhur një rritje e ndjeshme e riskut kreditor për një ekspozim që ndryshon klasifikimin e riskut rregullator nga standard tek nën vrojtim në përputhje me politikën e Organizatës për klasifikimin e riskun rregullator. Të gjitha kreditë që shfaqin rritje të ndjeshme në riskun kreditor klasifikohen në Kategorinë 2.

Si një rezervë, dhe siç kërkohet nga SNRF 9, Organizata me gjasë do të konsiderojë se një rritje e ndjeshme e riskut kreditor ndodh jo më vonë se kur një pasuri është më shumë se 30 ditë në vonesë. Organizata do të përcaktojë ditët në vonese duke numëruar numrin e ditëve që nga data më e hershme në vonesë për të cilën pagesa e plotë nuk është pranuar.

Përveq indikacionit të rezervës, organizata do të konsiderojë si një rritje e ndjeshme e riskut kreditor, nëse kredia klasifikohet nga standardi tek nën vrojtim ose në një klasë më të keqe të riskut ose kreditë e tjera të të njëjtit klient me Organizatën janë klasifikuar nga standardi nën vrojtim ose në një shkallë më keq të riskut. Organizata gjithashtu do të konsiderojë që risku është rritur nëse klienti kërkon një ristrukturim me masa lehtësuese siç janë: maturimi i zgjatur, kësti më i ulët, norma e interesit më e ulët, përjashtimet nga ndëshkimet dhe interesi i akumuluar.

3). POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Grupimi i kredive

Vlerësimi i përgjithshëm i probabilitetit të dështimit (PD)

Për qëllime të një vlerësimi të përgjithshëm të PD-së, KEP grupon kreditë në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut kreditor që janë tregues i aftësisë së debitorit për të paguar të gjitha shumatat e duhura sipas kushteve kontraktuale.

Duke marrë parasysh profilin e riskut kreditor për kreditë e saj, KEP ka zgjedhur të grupojë kreditë në bazë të **llojit të produktit** (agro kredi, biznesore, hipotekare, konsumuese).

Ekziston një segmentim i portofolit të kredisë bazuar në karakteristikat e ngjashme të riskut. Më poshtë janë paraqitur katër segmente të portofolit të kredisë:

- Agro
- Biznesore
- Konsumuese
- Hipotekare

Vlerësimi i përgjithshëm i kredive në dështim

Për qëllime të vlerësimit të përgjithshëm të HKND, kreditë janë grupuar në bazë të:

- ciklit të rikuperimit të mjeteve monetare për kreditë joperformuese; dhe
- kthimi pas shlyerjeve.

KEP rishikon në baza vjetore kufijtë dhe kriteret e përcaktuara për të siguruar që ato mbeten të vlefshme pas ndryshimeve të mundshme në madhësinë dhe përbërjen e portofolit të kredive.

Pasuritë financiare të modifikuara

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të ndryshohen për një numër arsyesh, duke përfshirë ndryshimin e kushteve të tregut, mbajtjen e klientëve dhe faktorëve të tjerë që nuk lidhen me një përkeqësim të tanishëm ose potencial të kredisë së klientit. Një kredi ekzistuese, kushtet e të cilave janë modifikuar, mund të ç'regjistrohen dhe kredia e rinegociuar të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë.

POCI: Pasuritë e blera ose të krijuara me rënie në vlerë (POCI) janë pasuritë financiare që kanë rënë në vlerë në njohjen fillestare. POCI pasuritë regjistrohen me vlerën e drejtë në njohjen fillestare dhe të ardhurat nga interesi njihen më pas në bazë të një EIR të rregulluar nga kredia. HPK njihen vetëm në masën që ka një ndryshim pasues në humbjet e pritshme kreditore të përhershme. Për pasuritë financiare për të cilat Organizata nuk ka shpresa të arsyeshme për rikthimin e të gjithë shumës së mbetur, ose një pjese të saj, vlera kontabël bruto e pasurisë financiare zvogëlohet. Kjo konsiderohet një çregjistrim (i pjesëshëm) i pasurisë financiare.

Sipas SNRF 9, kur kushtet e një pasurie financiare modifikohen dhe modifikimi nuk rezulton në ç'regjistrim, Organizata do të shqyrtojë nëse risku kreditor i pasurive është rritur ndjeshëm duke analizuar faktorët sasiorë dhe cilësorë që ndikojnë në riskun e vonësës.

Më konkretisht, Organizata do të vlerësojë nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë së instrumentit financiar duke krahasuar:

- rrezikun e një mospagimi që ndodh në datën e raportimit (bazuar në kushtet e modifikuara të kontratës); dhe
- rrezikun e një mospagimi që ndodh në njohjen fillestare (bazuar në kushtet origjinale, të pandryshuara të kontratës).

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

Pasuritë financiare të modifikuara (vazhdim)

Organizata rinegocion kreditë për klientët në vështirësi financiare (të referuara si 'aktivitete të ristrukturimit') për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe minimizuar riskun e dështimit. Sipas politikës së ristrukturimit të Organizatës, ristrukturimi i kredisë jepet në baza selektive nëse debitori momentalisht është në vonesë të borxhit të tij ose nëse ka një risk të lartë të vonesës, ka dëshmi se debitori ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të paguar sipas kontratës fillestare kushtet dhe debitori pritet të jetë në gjendje të përmbushë kushtet e rishikuara.

Kushtet e rishikuar zakonisht përfshijnë zgjatjen e maturitetit, ndryshimin e kohës së pagesave të interesit dhe ndryshimin e kushteve të kovenantave të kredisë. Kreditë individuale dhe biznese janë subjekt i politikës së ristrukturimit.

Në përgjithësi, ristrukturimi është një tregues cilësor i vonesës dhe rënies në vlerën kreditore dhe pritjet e ristrukturimit janë të rëndësishme për të vlerësuar nëse ka një rritje të konsiderueshme të riskut kreditor.

Pas ristrukturimit, një klient duhet të tregojë sjellje të mirë të pagesave në mënyrë të qëndrueshme gjatë muajve para se ekspozimi të matet në një shumë të barabartë me HPK 12-mujore.

Inputet në matjen e HPK

Inputet kryesore në matjen e HPK ka të ngjarë të jenë struktura e termave të variablave në vijim:

- probabiliteti i dështimit (PD);
- humbja kreditë në dështim (HKND); dhe
- ekspozimi në dështim (END).

Këta parametra do të rrjedhin nga modelet statistikore të zhvilluara brenda vendit dhe të dhëna të tjera historike që përdorin modelet rregullatore. PD-të do të rregullohen për të pasqyruar informacionin e ardhshëm si më poshtë.

Nivelet e riskut kreditor do të jenë një input primar në përcaktimin e strukturës së afateve të PD për ekspozimet. Organizata do të përdorë modele statistikore për të analizuar të dhënat e mbledhura dhe për të gjeneruar vlerësime të PD-së të jetës së mbetur të ekspozimeve si dhe këto pritjet të ndryshojnë si pasojë e kalimit të kohës.

Kjo analizë do të përfshijë identifikimin dhe kalibrimin e marrëdhënieve ndërmjet ndryshimeve në normat e vonuara dhe ndryshimet në faktorët kryesorë makroekonomikë, si dhe analizën e thellë të ndikimit të disa faktorëve të tjerë (p.sh. përvojën e ristrukturimit) në riskun e vonesës. Për shumicën e ekspozimeve, treguesit kryesorë makroekonomikë ka të ngjarë të përfshijnë rritjen e GDP-së, normat e interesit dhe papunësinë. Qasja e Organizatës për përfshirjen e informacioneve të ardhshme në këtë vlerësim është diskutuar më poshtë.

HKND është madhësia e humbjes së mundshme nëse ka vonesa. Organizata do të vlerësojë parametrat HKND bazuar në historinë e normave të rikuperimit të kërkesave ndaj palëve tjera. Modelet HKND do të konsiderojnë strukturën, kolateralin, vjetërsinë e kërkesës dhe kostot e rikuperimit të çdo kolaterali që është pjesë përbërëse e pasurive financiare.

Vlerësimet HKND do të kalibrohen për skenarë të ndryshëm ekonomikë dhe, për huadhënien e pasurive të paluajtshme, për të pasqyruar ndryshimet e mundshme në çmimet e pronës. Ato do të llogariten në bazë të rrjedhës së parasë të diskontuara duke përdorur normën efektive të interesit si faktor diskontues.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)**

(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)

END përfaqëson ekspozimin e pritur në rast të një vonese. Organizata do të nxjerr END nga ekspozimi aktual ndaj palës tjetër dhe ndryshimet e mundshme në shumën aktuale të lejuar sipas kontratës, përfshirë amortizimin dhe parapagimet. END e një pasurie financiare do të jetë vlera kontabël bruto në vonesë. Për zotimet e huadhënies dhe garancioneve financiare, END do të shqyrtojë shumën e tërhequr, si dhe shumat potenciale të ardhshme që mund të tërhiqen ose paguhen sipas kontratës, të cilat do të vlerësohen bazuar në vrojtimit historike dhe parashikimet e ardhshme.

Organizata matë HPK duke marrë në konsideratë riskun e vonesës për periudhën maksimale kontraktuale (duke përfshirë opsionet e zgjerimit të huamarrësit) mbi të cilat ai është i ekspozuar ndaj riskut kreditor, edhe nëse për qëllime të administrimit të riskut Organizata konsideron një periudhë më të gjatë. Periudha maksimale kontraktuale zgjat deri në datën në të cilën Organizata ka të drejtë të kërkojë kthimin e një paradhënie ose të përfundojë një zotim kredie apo garancion.

Informacionet e ardhshme (forward-looking)

Sipas SNRF 9, Organizata përfshinë informacione të ardhshme në të dyja vlerësimet e saj nëse riskut kreditor i një instrumenti është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe matja e saj HPK. Organizata formulon një pamje "të rastit bazë" të drejtimit të ardhshëm të variablave përkatëse ekonomike dhe një gamë përfaqësuese të skenarëve të tjerë të mundshëm të parashikimit bazuar në këshillat e Komitetit të Riskut të Organizatës dhe ekspertëve ekonomikë dhe shqyrtimin e një sërë informacionesh të jashtme aktuale dhe parashikuese.

Ky proces përfshinë zhvillimin e dy ose më shumë skenarëve ekonomikë shtesë dhe duke marrë parasysh probabilitetet relative të secilit rezultat. Informacioni i jashtëm mund të përfshijë të dhëna ekonomike dhe parashikime të publikuara nga organet qeveritare dhe autoritetet monetare në vendet ku vepron Organizata, organizata ndërkombëtare si Banka për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe sektori privat i përzgjedhur dhe parashikuesit akademikë.

Rasti bazë paraqet një rezultat më të mundshëm dhe harmonizohet me informacionin e përdorur nga Organizata për qëllime të tjera, siç është planifikimi strategjik dhe buxhetimi. Skenarët e tjerë do të përfaqësojnë rezultate më optimiste dhe më pesimiste. Organizata gjithashtu kryen në mënyrë periodike testimin e stresit të goditjeve më ekstreme për të kalibruar përcaktimin e këtyre skenarëve të tjerë përfaqësues.

Organizata ka identifikuar dhe dokumentuar nxitësit kryesorë të riskut kreditor dhe humbjet kreditore për secilin portfolio të instrumenteve financiare dhe duke përdorur një analizë të të dhënave historike, ka vlerësuar marrëdhëniet ndërmjet variablave makroekonomikë dhe riskut kreditor dhe humbjeve kreditore. Këta drejtues kryesorë përfshijnë normat e interesit, normat e papunësisë dhe parashikimet e BPV-së. Marrëdhëniet e parashikuara midis treguesve kryesorë dhe vonesave dhe normave të humbjeve në portofole të ndryshme të pasurive financiare janë zhvilluar bazuar në analizimin e të dhënave historike gjatë 5 viteve të fundit.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**e) Pasuritë financiare dhe detyrimet financiare (vazhdim)***(viii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë (vazhdim)*

Paraqitja e lejimeve për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar

Lejimet për humbjet për HPK janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar si më poshtë:

- pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar: si zbritje nga vlera kontabël bruto e pasurive;
- zotimet e kredisë dhe kontratat e garancioneve financiare: në përgjithësi, si një provizion;
- kur një instrument financiar përfshinë si një komponent të tërhequr dhe një jo të tërhequr, dhe Organizata nuk mund të identifikojë HPK në komponentin e zotimit të kredisë veçmas nga ato në komponentin e tërhequr të kredisë: Organizata paraqet një provizion të humbjes së kombinuar për të dy komponentët. Shuma e kombinuar paraqitet si një zbritje nga vlera kontabël bruto e përbërësit të tërhequr. Çdo tejkallim i provizionit të humbjes mbi shumën bruto të komponentit të tërhequr paraqitet si një provizion.

Kreditë e shlyera

Kreditë shlyhen (pjesërisht ose tërësisht) kur nuk ka një perspektivë reale të rikuperimit. Kjo zakonisht ndodh kur Organizata përcakton se huamarrësi nuk ka pasuri ose burime të ardhurash që mund të gjenerojnë rrjedha të parasë të mjaftueshme për të shlyer shumat që i nënshtrohen shlyerjes. Megjithatë, pasuritë financiare që janë shlyer mund të jenë ende subjekt i veprimeve përmbartimore në mënyrë që të jenë në përputhje me procedurat e Organizatës për mbulimin e shumave të duhura.

f) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë monedhat dhe kartëmonedhat në arkë, gjendjet në Bankën Qendrore të pakufizuara në përdorimin e pasurive financiare shumë likuide me maturim fillestar deri në tre muaj të cilat janë subjekt i një risku të parëndësishëm të ndryshimeve të vlerës së tyre të drejtë, dhe përdoren nga Organizata për menaxhimin e zotimeve afatshkurtëra.

Paraja dhe ekuivalentet e saj mbahen me kosto të amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

g) Huamarrjet

Huamarrjet janë burimet kryesore të Organizatës për financim.

Huamarrjet maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit dhe më pas maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

h) Prona dhe pajisjet

Zërat e pronës dhe pajisjeve janë matur sipas koston minus zhvlerësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga rënia në vlerë. Kostot përfshijnë shpenzime që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Kostoja e pasurive të vetë-konstruktura përfshinë koston e materialeve dhe të punës direkte, çdo kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me sjelljen e pasurisë në një gjendje pune për përdorimin e saj të synuar, si dhe kostot e çmontimit dhe heqjes së sendeve dhe rivendosjen e lokacionit në të cilin ato janë të vendosura. Kur pjesët e një pjese të pajisjeve kanë jetë të ndryshme të dobishme, ato llogariten si zëra të veçantë (komponentë kryesorë) të pajisjeve.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**h) Prona dhe pajisjet (vazhdim)**

Kostoja e zëvendësimit të një pjese te pajisjeve njihet ne vlerën kontabël te zërit ne qoftë se është e mundur që perfitimet e ardhshme ekonomike të integruara brenda pjesës do të derdhen në Organizatë dhe kostot e saj mund te maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet e servisimit të përditshëm të pajisjeve njihen në fitim ose humbje si të ndodhin.

Në fund të çdo periudhe raportuese, menaxhmenti vlerëson nëse ka ndonjë tregues të zhvlerësimit të pronës dhe pajisjeve. Nëse ndonjë tregues i tillë ekziston, menaxhmenti vlerëson shumën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një pasurie me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një pasuri në vitet e mëparshme kthehet mbrapsht, nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e pasurisë në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

Fitimet dhe humbjet nga shlyerjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën kontabël neto njihen në fitim ose humbje.

(i) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi në zërat e pronës dhe pajisjeve është llogaritur duke përdorur metodën lineare për të alokuar koston e tyre për vlerat e tyre të mbetura gjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar:

Vetura	5 vite
Mobilje dhe pajisje	5 vite
Kompjuterë dhe pajisje elektronike	5 vite
Përmirësimet e objekteve me qira	Afati më i shkurtër mes qirasë dhe jetës së tyre të dobishme

Vlerat e mbetura të pasurive dhe jetët e dobishme shqyrtohen, dhe rregullohen nëse është e përshtatshme në fund të çdo periudhe raportuese.

Pasuritë e paprekshme të blera nga Organizata shprehen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlera.

i) Pasuritë e paprekshme

Shpenzimet pasuese për pasuritë e paprekshme kapitalizohen vetëm kur rriten përfitimet ekonomike të ardhshme të integruara në pasurinë specifike të cilit i përket. Të gjitha shpenzimet e tjera janë shpenzime të ndodhura.

Amortizimi njihet në fitim ose humbje në bazë të linjës së drejtë gjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurive. Jeta e dobishme e vlerësuar e pasurive të paprekshme përcaktohet sipas vlefshmërisë së kontratës ose 10 vjet.

j) Qiraja

Detajet e politikave kontabël sipas SNK 17 dhe SNRF 16 janë paraqitur veçmas më poshtë.

Në fillimin e një kontrate, Organizata vlerëson nëse ajo kontratë është apo përmban një qira. Organizata njih një pasuri të përdorimit të së drejtës dhe një detyrim përkatës të qirasë në lidhje me të gjitha aranzhmanet e qirasë në të cilën është qiramarrësi. Për këto qira, Organizata njih pagesat e qirasë si një shpenzim operativ në bazë të drejtpërdrejtë për kohëzgjatjen e qirasë, përveç nëse një bazë tjetër sistematike është më përfaqësuese e modelit të kohës në të cilën konsumohen përfitimet ekonomike nga aktivet e marra me qira.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**j) Qiraja (vazhdim)**

Detyrimi i qirasë fillimisht matet me vlerën aktuale të pagesave të qirasë që nuk paguhen në datën e fillimit, e zbritshme nga norma e interesit për kredi . Nëse kjo normë nuk mund të përcaktohet me lehtësi, qiramarrësi përdor normën e tij të huamarrjes.

- Pagesat e qirasë të përfshira në matjen e detyrimit të qirasë përfshijnë:
- Pagesat fikse; (përfshirë pagesa fikse në substancë), minus çdo stimulim i arkëtueshëm i qirasë
- Pagesat variabile të qirasë të cilat varen nga një indeks apo normë fillimisht duke përdorur një indeks ose normë në datën e fillimit;
- Shuma që pritet të jetë e pagueshme nga qiramarrësi nën garancitë e vlerës së mbetur;
- Çmimi i ushtrimit të opsioneve të blerjes, nëse qiramarrësi është i sigurt për të ushtruar opsionet; dhe
- Pagesat e gjobave për ndërprerjen e qirasë, nëse afati i qirasë pasqyron ushtrimin e një opsioni për ndërprerjen e qirasë.

Detyrimi i qirasë paraqitet si linjë e veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Detyrimi i qirasë matet më pas duke rritur vlerën kontabël për të pasqyruar interesin mbi detyrimin e qirasë (duke përdorur metodën e interesit efektiv) dhe duke zvogëluar vlerën kontabël për të pasqyruar pagesat e qirasë së bërë. Organizata bën rimatjen për detyrimin e qirasë (dhe bën një rregullim përkatës ndaj aktivitet të lidhur me të drejtën e përdorimit) sa herë:

- Afati i qirasë ka ndryshuar ose ka një ngjarje të rëndësishme ose ndryshim të rrethanave që rezultojnë në një ndryshim në vlerësimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje, që në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë dhe duke përdorur një normë të rishikuar zbritje.
- Pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të ndryshimeve në një indeks ose normë ose një ndryshim në pagesën e pritshme nën një vlerë të mbetur të garantuar, në të cilin rast detyrimi i qirasë rimatet duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të pandryshuar zbritje (përveç nëse pagesat e qirasë ndryshojnë për shkak të një ndryshimi në një normë interesi variabil, në këtë rast përdoret një normë e rishikuar e skontimit).
- Një kontratë qiraje është modifikuar dhe modifikimi i qirasë nuk llogaritet si një qira e veçantë, në këtë rast detyrimi i qirasë rimatet bazuar në afatin e qirasë së modifikuar duke zbritur pagesat e rishikuara të qirasë duke përdorur një normë të rishikuar zbritje në efekt data e modifikimit.

Organizata nuk ka bërë ndonjë rregullim të tillë gjatë periudhave të paraqitura.

Asetet me të drejtë përdorimi përfshijnë matjen fillestare të detyrimit korrespondues të qirasë, pagesat e qirasë të bëra në ose para ditës së fillimit, minus çfarëdo stimuluj të marrë me qira dhe çdo kosto fillestare direkte. Ato më pas maten me kosto minus amortizim të akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë.

3. POLITIKAT MATERIALE KONTABËL (VAZHDIM)**j) Qiraja (vazhdim)**

Kurdoherë që Organizata të bëjë një detyrim për shpenzimet për çmontimin dhe heqjen e një aktivi të dhënë me qira, rivendos vendin në të cilin është vendosur ose rivendosur aktivin themelor në gjendjen e kërkuar nga termat dhe kushtet e qirasë, një provizion njihet dhe matet sipas SNK 37. Në atë masë që kostot lidhen me një aktiv të përdorimit të së drejtës, kostot përfshihen në aktivin e lidhur me të drejtën e përdorimit, përveç nëse ato shpenzime janë bërë për të prodhuar inventarë.

Asetet e përdorimit të së drejtës zhvlerësohen gjatë periudhës më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit themelor. Nëse qiraja transferon pronësinë mbi aktivin themelor ose koston e aktivit të së drejtës së përdorimit reflekton që Organizata pret të ushtrojë një mundësi blerjeje, aktivi i lidhur me të drejtën e përdorimit zhvlerësohet gjatë jetës së dobishme të aktivit themelor. Zhvlerësimi fillon në datën e fillimit të qirasë.

Asetet e përdorimit të së drejtës paraqiten si një linjë e veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar.

Qiraja variabile që nuk varet nga një indeks ose normë nuk përfshihen në matjen e detyrimit të qirasë dhe aktivit me të drejtë përdorimi. Pagesat e ndërlydhura njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ndodh ngjarja ose gjendja që shkakton ato pagesa.

Në praktikë, SNRF 16 lejon një qiramarrës të mos veçojë përbërësit jo-qira, dhe në vend të kësaj të llogarisë çdo kompensim qirash dhe përbërësish jo-qira si një marrëveshje e vetme. Organizata nuk e ka përdorur këtë praktikë. Për një kontratë që përmban një përbërës të qirasë dhe një ose më shumë komponentë të qirasë ose jo të qirasë, Organizata shpërndan vlerësimin në kontratë për secilin komponent të qirasë në bazë të çmimit relativ të pavarur të komponentit të qirasë dhe çmimit relative të komponentëve jo-qira.

k) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Organizata ka një detyrim aktual ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohej për të shlyer detyrimin. Provizionet përcaktohen duke zbritur flukset monetare të ardhshme të pritshme me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Zbërthimi i zbritjes njihet si kosto financiare.

l) Përfitimet e punonjësve*(i) Plani i përcaktuar i kontributeve*

Detyrimet për kontribute në planet e pensionit me kontribut të përcaktuar njihen si shpenzime në fitim ose humbje kur ato janë borxh. Organizata bën kontribute të detyrueshme të sigurimeve shoqërore që ofrojnë përfitime pensioni për punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për sigurimin e pragut minimal të përcaktuar me ligj për pensionet në Kosovë sipas një plani të pensionit me kontribut të përcaktuar.

(ii) Përfitimet afatshkurtëra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtëra të punonjësve maten mbi baza të padeklaruara dhe shpenzohen pasi ofrohet shërbimi i lidhur. Një provizion njihet për shumën që pritet të paguhet nën bonusin afatshkurtër të parave ose planet e ndarjes së fitimit nëse Organizata ka një detyrim ligjor ose konstruktiv aktual për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimit të kaluar të ofruar nga punëmarrësi dhe detyrimi mund të të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

4. MIRATIMI I STANDARDEVE NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR TË REJA DHE TË RISHIKUARA

4.1. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet që janë tashmë në fuqi.

Gjatë këtij viti, Organizata ka zbatuar një sërë ndryshimesh në Standardet e Raportimit Financiar Sipas SNRF, të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK), të cilat janë bërë të detyrueshme për periudhat kontabël që fillojnë më 1 janar 2025 ose më pas.

- Mungesa e këmbyeshmërisë (Ndryshime në SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit valutor).
- Pasiguritë në pasqyrat financiare - Ndryshime në shembujt ilustrues për SNRF 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet, SNRF 18 Paraqitja dhe shpalosja në pasqyrat financiare, SNK 1 Paraqitja e pasqyrave financiare, IAS 8 Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare, SNK 36 Zhvlerësimi i aktiveve dhe SNK 37 Provizionet, detyrimet e kushtëzuara dhe aktivet e kushtëzuara.

Ndryshimet e listuara më sipër nuk kanë pasur asnjë ndikim në shumat e njohura në periudhat e mëparshme dhe nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në periudhat aktuale ose të ardhshme.

4.2 Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e lëshuara por ende jo efektive

Standardet dhe interpretimet e reja dhe të ndryshuara që janë lëshuar, por ende nuk kanë hyrë në fuqi deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare, janë zbuluar më poshtë. Organizata synon të miratojë këto standarde dhe interpretime të reja dhe të ndryshuara, nëse janë të zbatueshme, kur ato të bëhen efektive.

Ndryshimet e mëposhtme nuk janë në fuqi për periudhën që fillon më 1 janar 2025:

- SNRF 17 Kontratat e sigurimit (duke përfshirë ndryshimet e qershorit 2020 dhe dhjetorit 2021 në SNRF 17)
- Ndryshime në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare (Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet financiare);
- Kontratat që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra (Ndryshime në SNRF 9 Instrumentet financiare dhe I SNRF 7 Instrumentet financiare: Shpalosjet);
- Përmirësimet vjetore të Standardeve të Kontabilitetit SNRF - Vëllimi 11;
- SNRF 18 Paraqitja dhe shpalosja në pasqyrat financiare;
- SNRF 19 Filialet pa përgjegjësi publike: Shpalosjet.

Këto standarde, ndryshime ose interpretime nuk pritet të kenë ndonjë ndikim material në Organizatë gjatë periudhave aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe në transaksionet e parashikueshme në të ardhmen.

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Organizata bën vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në përvojën historike dhe faktorë të tjerë, përfshirë pritjet e ngjarjeve të ardhshme për të cilat besohet se janë të arsyeshme në rrethana. Informacioni në lidhje me dispozitat dhe paparashikimet është i detajuar në shënimet 13 dhe 21.

a) Humbjet e pritshme kreditore

Pasuritë financiare të matura me koston e amortizuar ose instrumentet e borxhit të matura në FVOCI vlerësohen për zhvlerësim në bazë të përshkruar në Shënimin 3. (e). (vii). Organizata i rishikon rregullisht supozimet dhe gjykimet e saj.

Organizata mat humbjet e pritshme të kredisë nga një instrument financiar në një mënyrë që pasqyron:

- (i) një shumë e paanshme dhe me peshë të mundshme që përcaktohet duke vlerësuar një gamë të rezultateve të mundshme;
- (ii) vlerën kohore të parave; dhe
- (iii) informacion të arsyeshëm dhe të mbështetshëm që është në dispozicion pa kosto ose përpjekje të panevojshme në datën e raportimit për ngjarjet e kaluara, kushtet aktuale dhe parashikimet e kushteve të ardhshme ekonomike.

b) Përcaktimi i vlerave të drejta

Përcaktimi i vlerës së drejtë për aktivet financiare dhe detyrimet financiare për të cilat nuk ka çmim të konsiderueshëm të tregut kërkon përdorimin e teknikave të vlerësimit siç përshkruhet në Shënimin 3. (e). (vii). Për instrumentet financiare që tregtohen rrallë dhe kanë pak transparencë të çmimeve, vlera e drejtë është më pak objektive dhe kërkon shkallë të ndryshme gjykimi në varësi të likuiditetit, përqendrimit, pasigurisë së faktorëve të tregut, supozimeve të çmimeve dhe rreziqeve të tjera që ndikojnë në instrumentin specifik.

Organizata mat vlerat e drejta duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të metodave:

- Niveli 1: Çmimi i kuotuar i tregut është një treg aktiv për një instrument identik,
- Niveli 2: Teknika e vlerësimit bazuar në inputet e vëzhguara. Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuara duke përdorur: çmimet e kuotuar të tregut në tregjet aktive për instrumente të ngjashme; çmime të kuotuar për instrumente të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak se aktiv; ose teknika të tjera vlerësimi, kur të gjitha inputet domethënëse vëzhgohen drejtpërdrejt ose indirekt nga të dhënat e tregut.
- Niveli 3: Teknika vlerësimi duke përdorur të dhëna të konsiderueshme të pa kontrollueshme. Kjo kategori përfshin të gjitha instrumentet ku teknika e vlerësimit përfshin inputet që nuk bazohen në të dhëna të vëzhgueshme dhe inputet e pa kontrollueshme mund të kenë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente që vlerësohen bazuar në çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme, kur kërkohen rregullime ose supozime të konsiderueshme të pa kontrollueshme për të pasqyruar ndryshimet midis instrumenteve.

Vlerësimi i vlerës së drejtë shpaloset në shënimin 5 c) më poshtë:

c) Shpalosja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në instrumentet financiare ekzistues në pasqyrën e pozicionit financiar të Organizatës, pa u përpjekur të vlerësojnë vlerën e biznesit të parashikuar në të ardhmen dhe vlerën e aktiveve dhe detyrimeve që nuk konsiderohen instrumente financiare.

5. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE (VAZHDIM)**c) Shpalosja dhe vlerësimi i vlerës së drejtë (vazhdim)****Vlera e drejtë e instrumenteve financiare**

Kur është e mundur, vlera e drejtë e kredisë bazohet në transaksione të vëzhguara në treg. Kur transaksionet e vëzhguara të tregut nuk janë të disponueshme, vlera e drejtë vlerësohet duke përdorur modele vlerësimi, siç janë teknikat e zbritura të fluksit të parave. Futja në teknikat e vlerësimit përfshin humbjet e pritshme të kredisë dhe normat e interesit. Kreditë e vogla homogjene grupohen në portofole me karakteristika të ngjashme.

Vlera e drejtë e huazimeve vlerësohet duke përdorur teknikat e zbritura të fluksit të parave, duke aplikuar tarifatat që ofrohen për huazime të maturimeve dhe kushteve të ngjashme.

	31 dhjetor 2025		31 dhjetor 2024	
	Vlera e drejtë Niveli 3	Vlera kontabël	Vlera e drejtë Niveli 3	Vlera kontabël
Pasuritë Financiare				
Kredië dhe Paradhëniet për klientët	135,566	136,294	113,083	112,604
Detyrimet Financiare				
Huazimet	107,577	106,573	84,268	84,148

Vlerat kontabël të kredive dhe huazimeve më 31 dhjetor 2025 janë më të larta se vlerat e drejta për kredi, sepse normat aktuale të tregut janë prej 18.3% (bazuar në Raportin Mujoor të Sistemit Financiar për muajin dhjetor 2025, BQK), më të ultra për kredi dhe për 6% për huazime janë më të larta (2024: 18.7% më të ulëta për kredi dhe 6 % më të ulëta për huazimet).

6. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Paraja në bankë	9,265	4,879
Paraja e gatshme	845	742
	<u>10,110</u>	<u>5,621</u>

7. HUATË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTË

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Kreditë dhe paradhënie për klientët	138,987	115,563
Minus: Lejimi për rënie në vlerë	(2,693)	(2,959)
	<u>136,294</u>	<u>112,604</u>

Lëvizjet në lejimet për rënie në vlerë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Balanca më 1 janar	2,959	2,515
Shpenzimi i humbjes së kredisë për kreditë dhe paradhënie për klientët	1,039	1,110
Shumat e shlyera	(1,305)	(666)
Balanca me 31 dhjetor	<u>2,693</u>	<u>2,959</u>

7. HUATË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTË (VAZHDIM)

Kredi Agro <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	649	4	4	657
Pasuritë e reja të blera	917	-	-	917
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(936)	(4)	(1)	(941)
Transferet në Fazën 1	(2)	-	2	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(2)	(2)
Gjithsej	328	-	3	631

Kredi Agro <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	6	1	2	9
Pasuritë e reja të blera	3	-	-	3
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(3)	(1)	-	(4)
Transferet në Fazën 1	(2)	-	2	-
Transferet në Fazën 2	-	-	-	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(1)	(1)
Gjithsej	4	-	3	7

Kredi Agro >3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	21,343	137	154	21,634
Pasuritë e reja të blera	20,472	-	7	20,479
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(13,671)	(77)	(28)	(13,776)
Transferet në Fazën 1	(104)	22	82	-
Transferet në Fazën 2	-	(18)	18	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(51)	(51)
Gjithsej	28,040	64	182	28,286

Kredi Agro >3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	180	40	104	324
Pasuritë e reja të blera	80	-	15	95
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(54)	(19)	(40)	(113)
Transferet në Fazën 1	(74)	7	67	-
Transferet në Fazën 2	-	(12)	12	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(38)	(38)
Gjithsej	132	16	120	268

7. HUATË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTË (VAZHDIM)

Kredi për biznes <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	956	32	27	1,015
Pasuritë e reja të blera	767	-	-	767
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(970)	(29)	3	(996)
Transferet në Fazën 1	(18)	8	10	-
Transferet në Fazën 2	-	(1)	1	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(27)	(27)
Gjithsej	735	10	14	759

Kredi për biznes <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	8	10	20	38
Pasuritë e reja të blera	4	1	1	6
Pasuritë e shlyera ose të paguara	3	(9)	2	(4)
Transferet në Fazën 1	(9)	2	7	-
Transferet në Fazën 2	-	1	(1)	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(22)	(22)
Gjithsej	6	5	7	18

Kredi për biznes >3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	40,678	709	548	41,935
Pasuritë e reja të blera	40,520	62	4	40,586
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(26,408)	(536)	(53)	(26,997)
Transferet në Fazën 1	(660)	305	355	-
Transferet në Fazën 2	-	(75)	75	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(322)	(322)
Gjithsej	54,130	465	607	55,202

Kredi për biznes >3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	317	205	387	909
Pasuritë e reja të blera	211	39	74	324
Pasuritë e shlyera ose të paguara	184	(173)	(84)	(73)
Transferet në Fazën 1	(347)	88	259	-
Transferet në Fazën 2	-	(55)	55	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(249)	(249)
Gjithsej	365	104	442	911

7. HUATË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTË (VAZHDIM)

Kredi konsumuese <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	21,918	310	581	22,809
Pasuritë e reja të blera	30,950	-	-	30,950
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(27,756)	(251)	(14)	(28,021)
Transferet në Fazën 1	(870)	253	617	-
Transferet në Fazën 2	-	(38)	38	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(535)	(535)
Gjithsej	24,242	274	687	25,203

Kredi konsumuese <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	414	121	469	1,004
Pasuritë e reja të blera	403	48	183	634
Pasuritë e shlyera ose të paguara	254	(133)	(150)	(29)
Transferet në Fazën 1	(578)	85	493	-
Transferet në Fazën 2	-	(31)	31	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(476)	(476)
Gjithsej	493	90	550	1,133

Kredi për shtëpi <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	1,417	43	59	1,519
Pasuritë e reja të blera	933	-	-	933
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(1,325)	(34)	(6)	(1,365)
Transferet në Fazën 1	(35)	6	29	-
Transferet në Fazën 2	-	(5)	5	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(47)	(47)
Gjithsej	990	10	40	1,040

Kredi për shtëpi <=3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	15	13	46	74
Pasuritë e reja të blera	6	1	-	7
Pasuritë e shlyera ose të paguara	12	(9)	(2)	1
Transferet në Fazën 1	(24)	2	23	1
Transferet në Fazën 2	-	(4)	4	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(40)	(40)
Gjithsej	9	3	31	43

7. HUATË DHE PARADHËNIET PËR KLIENTË (VAZHDIM)

Kredi për shtëpi >3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
Vlera kontabël bruto më 1 janar 2025	25,065	628	300	25,993
Pasuritë e reja të blera	18,218	7	3	18,228
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(15,696)	(409)	(25)	(16,130)
Transferet në Fazën 1	(249)	148	101	-
Transferet në Fazën 2	-	(39)	39	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(222)	(222)
Gjithsej	27,338	335	196	27,869

Kredi për shtëpi >3000

	Faza 1	Faza 2	Faza 3	Gjithsej
HPK lejimi më 1 janar 2025 sipas SNRF 9	174	200	225	599
Pasuritë e reja të blera	58	8	5	71
Pasuritë e shlyera ose të paguara	(11)	(152)	(27)	(190)
Transferet në Fazën 1	(112)	40	72	-
Transferet në Fazën 2	-	(27)	27	-
Transferet në Fazën 3	-	-	-	-
Shumat e shlyera	-	-	(167)	(167)
Gjithsej	109	69	135	313

	Më 31 dhjetor 2025			Më 31 dhjetor 2024		
	Faza 1	Faza 2	Faza 3	POCI	Gjithsej	Gjithsej
Kredi dhe paradhëniet	136,101	1,155	1,730	-	138,986	115,563
Rreziku i ulët	135,898	320	-	-	136,218	113,223
Nën vëzhgim	167	478	-	-	645	426
Nën-standard	36	287	-	-	323	280
Të dyshimta	-	70	597	-	667	554
Të rëna në vlerë	-	-	1,133	-	1,133	1,080
Minus: Lejimi për rënie në vlerë	1,119	282	1,292	-	2,693	2,959
Vlera e mbetur	134,982	873	438	-	136,294	112,604

8. PASURI TË TJERA

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Shpenzime të parapaguara	131	121
Paradhënie për punonjësit	18	17
Të arkëtueshme të tjera	71	53
	220	191

Shpenzimet e parapaguara përfshijnë parapagimet prej 30 Euro për licenca vjetore të Microsoft 365 për vitin 2026, 30 Euro komision të menaxhimit të kredisë për huamarrjen e kontraktuar dhe të pa-disbursuar gjatë vitit 2025 dhe 26 Euro për sigurimin e përgjegjësisë të drejtorëve.

9. PRONA DHE PAJISJET

	Mjete motorike	Kompjuterat dhe pajisje elektronike	Furnizime dhe rregullime	Përmirosi me të hapsirave me qira	Gjithsej
Kosto					
Balanca më 1 janar 2024	643	692	1,182	782	3,299
Shtesat	107	56	80	102	345
Shlyerjet	-	(5)	(31)	-	(36)
Balanca më 31 dhjetor 2024	750	743	1,231	884	3,608
Shtesat	145	73	90	83	391
Shlyerjet	(10)	(36)	(19)	-	(65)
Balanca më 31 dhjetor 2025	885	780	1,302	967	3,934
Zhvlerësimi i akumuluar					
Balanca më 1 janar 2024	(573)	(510)	(838)	(390)	(2,311)
Zhvlerësimi për vitin	(50)	(71)	(108)	(103)	(332)
Shlyerjet	-	5	30	-	35
Balanca më 31 dhjetor 2024	(623)	(576)	(916)	(493)	(2,608)
Zhvlerësimi për vitin	(47)	(75)	(110)	(111)	(343)
Shlyerjet	10	36	18	-	64
Balanca më 31 dhjetor 2025	(660)	(615)	(1,008)	(604)	(2,887)
Vlerat e mbetura					
Më 31 dhjetor 2024	127	167	315	391	1,000
Më 31 dhjetor 2025	225	165	294	363	1,047

Më 31 dhjetor 2025, Organizata nuk ka ndonjë pronë ose pajisje të zotuar si kolateral (2024: zero).

10. PASURI TË PAPREKSHME

	<i>Programe/Softuere</i>
Kosto	
Balanca më 1 janar 2024	799
Shtesat	28
Balanca më 31 dhjetor 2024	827
Shtesat	87
Balanca më 31 dhjetor 2025	914
Amortizimi i akumuluar	
Balanca më 1 janar 2024	(285)
Amortizimi për vitin	(32)
Balanca më 31 dhjetor 2024	(317)
Amortizimi për vitin	(31)
Balanca më 31 dhjetor 2025	(348)
Vlera e mbetur	
Më 31 dhjetor 2024	510
Më 31 dhjetor 2025	566

11. TË DREJTAT PËR PËRDORIM TË PASURIVE DHE DETYRIMET NGA QIRAJA

	E drejta e përdorimit të aktivitetit Ndërtesa
Kosto	
Më 1 janar 2024	3,411
Shtesat	455
Shlyerjet	(1,571)
Më 31 dhjetor 2024	2,295
Shtesat	349
Shlyerjet	-
Më 31 dhjetor 2025	2,644
Zhvlerësimi i akumuluar	
Më 1 janar 2024	(1,947)
Zhvlerësimi	(469)
Shlyerjet	1,571
Më 31 dhjetor 2024	(845)
Zhvlerësimi	(495)
Shlyerjet	2
Më 31 dhjetor 2025	(1,338)
Vlera neto në libra më	
31 dhjetor 2024	1,450
31 dhjetor 2025	1,306

11. TË DREJTAT PËR PËRDORIM TË PASURIVE DHE DETYRIMET NGA QIRAJA (VAZHDIM)

	Detyrimi për qira
Detyrimet për qira më 1 janar 2024	1,477
Shtesat	455
Shlyerjet	-
- minus pagesat per qira	(538)
+ Interesi në detyrimet për qira	95
Detyrimet për qira më 31 dhjetor 2024	1,489
Shtesat	349
Shlyerjet	-
- minus pagesat per qira	(578)
+ Interesi në detyrimet për qira	101
Detyrimet për qira më 31 dhjetor 2025	1,361

Maturimi i detyrimit per qira

Jo më të vjetra se një vit	525
Më të vjetra se një vit dhe jo më të vjetra se pesë vite	836
Më të vjetra se pesë vite	-
Gjithsej	1,361

Organizata ka me qira disa pasuri të cilat përfshijnë lokale. Afati mesatar i qirasë është 5 vjet.

Organizata nuk përballlet me një rrezik të konsiderueshëm të likuiditetit në lidhje me detyrimet e saj të qirasë. Detyrimet e qirasë monitorohen në funksion të thesarit të Organizatës.

Të gjitha obligimet e qirasë janë të shprehur në njësi monetare.

Gjithsej dalja e parasë për qira në vitin 2025 ishte 578 Euro (2024: 538 Euro).

12. HUAMARRJET

Më 31 dhjetor 2024 dhe 2025, huatë e Organizatës përbëhen si në vijim:

31 dhjetor 2024

Huadhënës ndërkombëtar	Rangu i maturimit	Vlera
Normë fikse e interesit	21 - 49 muaj	36,938
Normë e luhatshme e interesit	25 - 51 muaj	33,569

Hudhënës vendor

Me normë fikse	Rangu i maturimit	Vlera
Mbitërheqje	24 - 37 muaj	12,109
	12 muaj	943
	Principali i mbetur	83,559
	Interes i përllogaritur	1,152
	Tarifa e shtyrë	(563)
	Gjithsej	84,148

31 dhjetor 2025

Huadhënës ndërkombëtar	Rangu i maturimit	Vlera
Normë fikse e interesit	36 - 48 muaj	62,772

Normë e luhatshme e interesit	25 - 51 muaj	31,206
-------------------------------	--------------	--------

Hudhënës vendor

Me normë fikse	Rangu i maturimit	Vlera
Mbitërheqje	36 - 37 muaj	12,100
	12 muaj	-
	Principali i mbetur	106,078
	Interes i përllogaritur	1,218
	Tarifa e shtyrë	(723)
	Gjithsej	106,573

Gjithsej shpenzimet e interesave për këto huamarrje në vitin 2025 janë 6,080 Euro (2024: 4,831 Euro).

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Principali i mbetur më 1 janar	83,559	67,257
Disbursimi gjatë vitit	56,200	47,929
Pagesa gjatë vitit	(33,681)	(31,627)
Principali i mbetur më 31 dhjetor	106,078	83,559
Interesi dhe tarifatat e përllogaritura më 1 janar	589	317
Shpenzimet e interesit	6,080	4,831
Interesi i paguar	(6,174)	(4,559)
Interesi dhe tarifatat e përllogaritura më 31 dhjetor	495	589
Gjithsej	106,573	84,148

12. HUAMARRJET (VAZHDIM)

Organizata ka një lejesë të mbitërheqjes me një bankë lokale në vlerë 1,000 Euro në total dhe maturitet deri 23 janar 2026. Më 31 dhjetor 2025, Organizata nuk e ka shfrytëzuar këtë mbitërheqje (2024: 943 Euro).

Organizata ka siguruar mbitërheqjen dhe kreditë me tri banka lokale me një portfolio kredie në total 13,827 Euro në fund të dhjetorit 2025 (mbitërheqje dhe kredi 2024: 10,160 Euro), bazuar në kushtet e kontraktuara të dakorduara të cilat përfshijnë një mbulim prej 150% të ekspozimit aktual me një portfolio me zero rrezik.

Më 31 dhjetor 2025, të gjitha pagesat e kredive janë kryer në kohë.

Më 31 Dhjetor 2025, Organizata është në përputhje me kushtet financiare (kovenantat) të përcaktuara në marrëveshjet me huamarrësit. Ndërsa në datën 31 Dhjetor 2025 Organizata ka qenë në përputhje me të gjitha marrëveshjet financiare të bashkangjitura në marrëveshjet me huamarrësit.

13. PROVIZIONET

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Provizionet për çështje gjyqësore	146	277
Provizionet të tjera për humbjet	18	7
Më 31 dhjetor	164	284

Provizionet për pretendimet juridike kanë të bëjnë kryesisht me çështjet gjyqësore në vazhdim të ngritura nga ish-punonjësit kundër Organizatës.

Provizionet e tjera për humbjet prej 18 Euro (2024: 7 Euro), kanë të bëjnë me çështjet juridike të cilat janë fituar nga Organizata në të kaluarën dhe më pas janë apeluar nga palët e treta, të cilat menaxhmenti besojnë se do të humbasin.

Lëvizjet në shpenzimet e provizionit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Më 1 janar	284	500
Ndryshimi i provizionit për pretendimet ligjore	(17)	(216)
Provizion për asete tjera	11	-
Paguar për çështje gjyqësore gjatë vitit	(114)	-
Më 31 dhjetor	164	284

14. DETYRIME TJERA

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Shpenzimet e përllogaritura	146	31
Taksa në burim mbi interesin	82	58
Kontribute pensionale dhe tatimi mbi të hyrat personale	137	125
Tatimi në fitim	113	(27)
Të pagueshmet	23	27
Detyrime të tjera	103	211
Gjithsej	604	425

Detyrimet e tjera përfshijnë 54 EUR ndaj furnitorëve dhe 35 EUR që lidhen me fondin e garancisë së portofolit të humbjeve të EIF për qëndrueshmërinë e NVM-ve.

Shpenzimet e përllogaritura përfshijnë 95 EUR në lidhje me çmimin “Dega më e Mirë” për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025, 10 EUR që lidhen me detyrimet për furnizim me energji elektrike, dhe 15 EUR për tarifën tremujore të komisionit të pagueshme ndaj BQK-së.
(Të gjitha vlerat janë të shprehura në ‘000 Euro përveç nëse theksohet ndryshe)

15. TË HYRAT NGA INTERESI

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Të ardhurat e interesit nga kreditë dhe paradhëniet	21,636	17,840
Të ardhurat e interesit nga bankat	66	93
Gjithsej	21,702	17,933

Më 31 dhjetor 2025, Organizata ka grumbulluar interes prej 95 Euro (2024: 93 Euro) për huatë e vonuara.

16. TË HYRAT TJERA

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Rikuperimet nga huatë e shlyera	377	366
Të ardhurat nga shitja e asetëve fikse	7	6
Të ardhurat tjera operative	26	27
Gjithsej	410	399

17. SHPENZIMET E PERSONELIT

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Paga dhe kompensime	4,745	4,157
Kontribute të detyrueshme sociale dhe shëndetësore	263	232
Të tjera	590	457
Gjithsej	5,598	4,846

Më 31 dhjetor 2025, Organizata kishte të punësuar 276 punonjës (2024: 273).

18. SHPENZIMET ADMINISTRATIVE

	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024
Shpenzime të publicitetit dhe marketingut	333	307
Shpenzimet e komunikimit	261	283
Shpenzimet për sigurimin e zyreve	251	252
Shërbime juridike, konsulencë dhe tarifa profesionale	352	239
Shërbime komunale	209	158
Derivate dhe parkim	86	88
Kompensime dhe udhëtime të Bordit	109	85
Riparime dhe mirëmbajtje	82	78
Furnizim të zyrës	61	71
Shpenzimet për polisa të sigurimeve	64	63
Zhvillimi i stafit	25	19
Udhëtime	11	15
Akomodim	7	10
Shpenzime reprezentacioni	13	7
Të tjera	185	200
Gjithsej	2,049	1,875

19. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIM

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024
Fitimi para tatimit	6,437	4,990
Korigjimet	(172)	(41)
Fitimi i tatueshëm	6,265	4,949
Tatimi në fitim	626	495
Norma efektive e tatimit	9.73%	9.92%

Pas vendimit të Bordit të Organizatës që duke filluar nga viti 2018, Organizata njeh dhe paguan tatimin mbi të ardhurat në mënyrë vullnetare, pavarësisht statusit të përfitimit publik. Shpenzimi i tatimit së të ardhurave për vitin 2025 ishte 626 Euro (2024: 495 Euro).

Pas rinovimit të Statusit të Përfitimit Publik në 2017, Organizata nuk ishte përgjegjëse të paguante tatimin mbi të ardhurat, dhe u lirua nga tatimi mbi të ardhurat. Bordi i Drejtorëve vendosi të ndërpresë vullnetarisht Statusin e Përfitimit Publik nga viti 2018 e në vazhdim, rrjedhimisht, tatimi mbi të ardhurat e korporatave aplikohet në masën 10%.

20. TRANSAKSIONET ME PALË TË LIDHURA

Organizata ka lidhje me “palë të lidhura” me drejtorët e saj dhe zyrtarët ekzekutiv. Siç përshkruhet në Shënimin 1, Organizata është një Organizatë Jo-Qeveritare. Prandaj, nuk ka “prind” ose aksionarë themelorë.

Transaksionet me palët e lidhura

Një përmbledhje e kompensimeve dhe shpenzimeve të tjera për drejtorët dhe menaxhmentin kryesor për periudhat që përfunduan me 31 dhjetor 2025 dhe 2024 është si më poshtë:

	Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025		Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2024	
	Shpërblimi	Shpenzime tjera	Shpërblimi	Shpenzime tjera
Menaxhmenti ekzekutiv	224	10	247	10
Bordi i Drejtorëve	63	46	45	40
Gjithsej	287	56	292	50

21. ZOTIMET DHE KONTIGJENCAT

Ligjore

Me përjashtim të provizioneve të krijuara më 31 dhjetor 2025 (shiko shënimin 13), menaxhmenti beson se nuk ka çështje gjyqësore ose kërkesa të tjera të sjella nga palë të treta që mund të rezultojnë në prurje ose humbje të konsiderueshme të parave në të ardhmen.

22. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

22.1 Hyrje dhe përmbledhje

Organizata ka ekspozim ndaj rreziqeve të mëposhtme nga përdorimi i instrumenteve financiare:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut

Ky shënim paraqet informacion në lidhje me ekspozimin e Organizatës ndaj secilit prej rreziqeve të mësipërme, objektivat, politikat dhe proceset e Organizatës për matjen dhe menaxhimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Organizatës. Shpalosjet e mëtejshme sasiore janë përfshirë në të gjitha këto pasqyra financiare.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Organizatës nëse një klient ose një palë tjetër e një instrumenti financiar dështon të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale dhe rrjedh kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e organizatës për klientët dhe bankat e tjera. Për qëllime të raportimit për menaxhimin e rrezikut, Organizata merr parasysh të gjitha elementet e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (të tilla si rreziku i parazgjedhur i detyrimeve të individit, rreziku i vendit dhe sektorit). Ekspozimi kryesor i organizatës ndaj rrezikut të kredisë lind nëpërmjet huave dhe paradhënieve të saj. Shuma e ekspozimit të kredisë në këtë drejtim përfaqësohet nga vlerat kontabël të aktiveve. Organizata nuk ka ndonjë ekspozim domethënës për asnjë klient ose palë individuale. Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë përfaqësohet nga vlera kontabël e çdo aktivi financiar. Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësinë për menaxhimin e rrezikut të kreditit tek menaxhmenti. Auditimet e rregullta të njësive të biznesit dhe proceset e kreditit ndërmerren nga Departamenti i Auditimit të Brendshëm.

Lejimi për rënie në vlerë

Organizata krijon një provizion për humbjet e pritshme nga kreditë (ECL) në portofolin e saj të huave në përputhje me IFRS 9.

Modeli ECL kërkon njohjen e humbjeve nga kreditë bazuar në informacion të orientuar drejt së ardhmes, në vend të humbjeve të realizuara. Provizioni matet në një shumë të barabartë me njërën nga sa vijon:

- Humbjet e pritshme 12-mujore për aktivet financiare ku nuk ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë që nga njohja fillestare (Faza 1); ose
- Humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës për aktivet financiare ku ka pasur një rritje të konsiderueshme të rrezikut të kredisë (Faza 2) ose që janë të dëmtuara nga kredia (Faza 3).

Vlerësimi i humbjeve të pritshme nga kreditë kryhet si në:

- bazë individuale për ekspozime të rëndësishme; dhe
- bazë kolektive për grupe të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë.

Vlerësimi kolektiv përfshin përvojën historike të humbjeve, kushtet aktuale dhe informacionin e orientuar drejt së ardhmes.

Kreditë me terma të rinegociuara

Kreditë me terma të rinegociuara janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të pozicionit financiar të huamarrësit dhe ku Organizata ka bërë lëshime që nuk do të mernte në konsideratë.

22. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

22.2 Hyrje dhe përmbledhje

Pasi të ristrukturohet kredia, ajo duhet të klasifikohet në kategorinë minimale të standardit ose më keq dhe do të vazhdojë të klasifikohet në të njëjtën kategori, derisa të vërehet performanca e qëndrueshme (në lidhje me ripagimin e principalit dhe interesin, sipas planit të ripagimit). Më 31 dhjetor 2025, huatë me terma të rinegociuar janë 177 EUR (2024: 167 EUR). Paguesa e zhvlerësimit të huave me kushte të rinegociuara më 31 dhjetor 2025 është 60 EUR (2024: 45 EUR).

22.3 Rreziku kreditor (vazhdim)

Politika e shlyerjes

Organizata shlyen një kredi (dhe çfarëdo lejimi të lidhur me humbjet nga zhvlerësimi) kur Menaxhmenti përcakton që kredia është e pambledhshme. Ky përcaktim arrihet pasi të merren parasysh informacione të tilla si shfaqja e ndryshimeve të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit, në mënyrë që huamarrësi të mos mund të paguajë më detyrimin, ose që të ardhurat nga kolaterali nuk do të jenë të mjaftueshme për të paguar tërë ekspozimin. Për kreditë e standardizuara me bilanc të vogël, vendimet për shlyerjen bazohen në përgjithësi në një status të caktuar të caktuar të produktit. Kreditë zakonisht shlyhen kur ato vonohen më shumë se 365 ditë (2024: 365 ditë), dhe asnjë pagesë nuk është bërë gjatë gjashtë muajve të fundit. Shuma totale e kredive të shlyera është paraqitur në Shënimin 7. Totali i rikuperimeve nga huatë e shlyera paraqitet në Shënimin 7.

Klasifikimi i kredive sipas llojit janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Agrikulturë	28,642	21,957
